

Qasja e re për Zgjerimin: *idetë e mira në nevojë për një kapiten*

Propozimi i Komisionit Evropian për një rishikim të qasjes për Zgjerimin i hap rrugën propozimeve kyçe për Raportin Rajonal Anti Korrupsion të SELDI-it dhe dokumenteve për politikën, përfshirë:

- një fokus më të madh në angazhimet politike dhe bazat ekonomike;
- Edukimi për përpjekjet antikorrupsion duke i integruar në më shumë politika e jo vetëm në institucionet antikorrupsion dhe në gjyqësor;
- Një angazhim i vazhdueshëm e i dukshëm në reforma nga elita e vendit;

- Trajtimi i influencës malinje nga vendet e treta;
- Mbrojtjen e rëndësishme midis marrëdhënieve KE – shoqëri civile, përfshirë dhe mbështetjen e tyre financiare prej ndryshimeve të papritura.

Vitaliteti i angazhimit të BE-së për qasjen e re do të testohet së shpejti në Samitin BE - Ballkan Perëndimor në Zagreb në maj 2020. Ndikimi i tyre, në fund të fundit do të varet nga lidhshëria, vullneti dhe aftësitë e BE-së për ta bërë demokracinë të dukshme për rajonin.

Nga përafrimi i *acquis* tek zgjidhja e problemeve

Një nga pikat kryesore të qasjes së re për Zgjerimin është rritja e angazhimit politik gjatë procesit, për të cilin SELDI ka mbështetur nëpërmjet [Forumit Rajonal Kundër Korrupsionit në Shkup](#) në dhjetor të vitit 2019. Kjo mund të jetë e dobishme nëse përdoret në përputhje dhe përafrimin me punën e *acquis* drejt zgjidhjes së problemeve thelbësore të qeverisjes në rajon dhe në vendet individuale. Qëllimi i një plani të mirë shtruar është që, në fund të procesit, vendi kandidat, ose më pas si një shtet anëtar i ardhshëm, pas vështirësive të rikthehet në gjendjen e mëparshme pozitive. Përafrimi me *acquis* është një çështje e nivelit të dytë ose themelor në këtë drejtim. Në përvojën e SELDI-it, kjo ndarje midis çështjeve të qeverisjes politike dhe teknike në Zgjerim përkthehet në trajtimin e kapjes së shtetit dhe korrupsionit të nivelit të lartë përballë ryshfetit të xhepit dhe korrupsionit të përditshëm. Një nga shpjegimet e vrojtimit në lidhje me [rikthimin e përhapjes së korrupsionit në rajon](#) në periudhën 2016 - 2019 është ngulitja e praktikave të kapjes së shtetit të mbështetur nga influenca e jashtme jo liberale. Këto dy të fundit nuk mund të trajtohen me mjete teknike.

Kjo do të thotë që qëllimi i anëtarësimit lidhet me një nivel kapaciteti institucional dhe kushteve shoqërore, të cilat mund t'i rezistojnë sulmeve të papritura dhe tundimit kundër qeverisjes demokratike që çon drejt korrupsionit sistemik ose aktorëve jo liberalë. Aktualisht, ky nuk është rasti në asnjë prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, madje as e fushës thelbësore ku operojnë [institucionet anti-korrupsion \(agjencitë /autoritetet\)](#). Mungesa e qëndrueshmërisë së dukshme në ngritjen e kapaciteteve dhe përkufi-

-zimi i autoritetit në agjencitë anti-korrupsion në rajon tregon frikë të thellë dhe mungesë vullneti të elitave për të krijuar institucione të forta e të pavarura. Por, gjithashtu demonstroi mungesën e një gjurme të qartë, të instrumenteve dhe levave nga ana e BE për ti shtyrë reforma të tilla përtej pikës së ngjitjes.

Në aspektin e integritetit, kjo nënkupton pavarësinë dhe kapacitetin e institucioneve rregullatore e mbikëqyrëse, për të fituar autoritetin parandalues apo ndëshkues që të rritet pajtueshmëria. Aktualisht, vendet e WB6 (6 vendet e Ballkanit Perëndimor) shfaqin performancë të dobët në shumë fusha të rregullimit, duke i hapur rrugë shfrytëzimit për përfitime private.

Qasja bazuar në grupe, e propozuar nga Komisioni ofron një mundësi për të arritur ndërhyrje holistike dhe për të ndihmuar vendet candidate aktuale dhe të ardhshme në zgjidhjen e problemeve të ngushta të qeverisjes. Sidoqoftë, udhëtreguesit e grupit duhet të planifikohen dhe bazohen në një teori të shëndoshë të ndryshimit. Komisioni duhet të jetë i kujdesshëm që të mos sigurojë një nën-grup të çështjeve më kritike për kapitullin e *acquis* për të formuluar këto udhëtregues. Përkundrazi, ai duhet të përqendrohet në problemet ndërlidhëse më domethënëse dhe të përcaktohen indikatorë performance reale që sinjalizojnë ndryshime të dukshme për qytetarët. Këto sinjale duhet të bëhen të qarta dhe të pranuar nga të gjithë aktorët përkatës të BE-së, përfshirë institucionet e BE-së, delegacionet e vendeve, familjet e partive politike dhe shtetet anëtare.

Përfshirja e Shoqërisë Civile

BE-ja duhet të përdorë mjetet ekzistuese të analizës, monitorimit dhe vlerësimit të hartuara nga shoqëria civile për të identifikuar zonat e cenueshme dhe më pas të verifikojë progresin ose regresin. Më e rëndësishmja, BE duhet të konsultohet jo vetëm me autoritetet vendase, por të përfshijë shoqërinë civile kur përcakton qëllimet përfundimtare dhe udhëtreguesin e grupeve.

Sigurimi i një legjitimiteti demokratik të mëtejshëm të procesit të Zgjerimit kërkon që BE të përdorë ‘trekëndëshin’ në proces, duke përfshirë shtimin e përpjekjeve të jashtme, organizatat lokale të shoqërive civile dhe politikanët me mendje reformiste nga qeveritë dhe opozitat në rajon.

Tashmë, shoqëria civile është depoja më e gjerë e njohurive si për ofrimin e zgjidhjeve ashtu edhe për vlerësimet e zhvillimit, si dhe për të ndihmuar në reformat dhe ndryshimet momentale. KE e ka pranuar rolin jetësor të shoqërisë civile në Zgjerim duke ruajtur fushën dhe intensitetin e fondeve për organizatat e saj edhe në rastet kur vendi ka pësuar hapa mbrapa.

Me ndihmën e shoqërisë civile, Komisioni Evropian mund të lidhë më lehtësisht qëllimet ndërmjet kapitujve të veçantë me standardet ndërsektoriale (d.m.th. të grupeve) të cilat kanë kuptim dhe mund të arrijnë fuqinë e nevojshme të institucioneve.

Për shembull, SELDI mund të ndihmojë BE-në me [instrumentet kryesore inovative](#) për [monitorimin e niveleve të viktimizimit të korrupsionit](#), përmirësimin e qeverisjes individuale të institucioneve publike dhe [identifikimin dhe trajtimin e kapjes së shtetit](#) (dhe kapje të politikave të tij, të rregullatorit, të medias, të gjyqësorit, etj.).

KE duhet të sigurojë që instrumente të tilla të palëve të treta do të lidhen më lehtë me vlerësimin e progresit mbi bazat e forcës së ligjit.

Në të njëjtën kohë, BE duhet të rrisë mbështetjen direkte të përgjithshme nga Brukseli në sektorin privat dhe shoqërinë civile në monitorimin e zhvillimeve në forcimin e ligjit. Aktualisht, shoqëria civile është aktive në analizimin e praktikave korruptive, gjyqësorit dhe drejtësisë penale, prokurimeve dhe shumë fusha të tjera të cenueshme.

Kjo duhet të vazhdojë dhe BE duhet të bëjë presion që shoqërisë civile ti lejohej qasje më e lehtë në institucionet qeveritare përkatëse. Në veçanti, BE duhet të përqendrohet në përpjekjet rajonale që inkurajojnë dhe sigurojnë sinergji në të gjithë vendet.

Zhvillimi i Rezistencës Shoqërore

Investimet shtetërore dhe të BE-së në reformat institucionale kanë qenë prej kohësh një instrument i disponueshëm në procesin e pranimit. Sidoqoftë, qasja e re sinjalizon një vetëdije të rritur dhe synim për të shoqëruar këto investime me ndërhyrje në zhvillimin ekonomik.

Ky është një shtesë e mirëpritur. Duhet të jetë e balancuar me më shumë leva qeverisjeje të BE, p.sh. planifikimi dhe tenderimi i infrastrukturës së rrjetit në rajon, direkt nga Brukseli me oferta konkurruese ndër-Evropiane.

Lufta e qëndrueshme kundër korrupsionit sistemik ose de-demokratizimi nuk mund të arrihet në mes të klientelizmit të përhapur e të pranishëm në WB6. Vullneti politik për të mos shfrytëzuar lidhjet klienteliste nuk mund të garantojë qëndrueshmëri nëse institucionet publike janë punëdhënësi dhe prokuruesi më i madh, pa mbikëqyrjen e detajuar dhe zbatimin e duhur. Risqet mbeten aty duke pritur që dikush t'i përdorë ato.

Kështu që, zhvillimi ekonomik duhet të jetë guri i themelit i ndërhyrjes aderuese dhe jo pritshmëria për përmirësim të qeverisjes. Kjo do të rriste pavarësinë e bizneseve nga politikanët dhe do të bënte besnikërinë e votuesve më të kushtueshme për t'u ruajtur përmes klientelizmit apo shpenzimeve me kritere të paqarta të fonde-

-ve publike për shkak të lobingjeve individuale të deputetëve/kryebashkiakëve etj., që çojnë në investime preferenciale, vepra ose shërbime publike të cilat sjellin përfitime për të zgjedhurit vendor deputët etj. (politika “**pork-barrel**”)

BE-ja duhet të kërkojë dhe promovojë në mënyrë aktive mundësi investimesh në rajon, si dhe të bëjë presion për miratimin universal të modeleve evropiane të qeverisjes korporative, siç është për shembull rregullat e OECD në menaxhimin e ndërmarrjeve shtetërore.

Sidoqoftë, përderisa zhvillimi ekonomik pranohet në komunikimin e paraqitur, është e vështirë të shihet ndonjë qasje e re specifike në ndihmë të ekonomive të WB6.

Ekziston rreziku që ndërsa vendet kandidatë të përfshihen në reforma në dekadën e ardhshme, kapitali i tyre njerëzor do të varfërohet nga migracioni dhe shumë prej popujve të tyre do të bëhen shtetas të BE-së përpara vendeve të tyre përkatëse.

Rreth Parashikueshmërisë

Parashikueshmëria e përparimit, si pasojë e arritjes së rezultateve duhet të jetë parimi thelbësor i qasjes së re, mes themeleve të përmirësuar politike të procesit. Rritja e kompleksitetit dhe pritshmërive për reformat në vendet candidate duhet të shoqërohet me kritere të qarta vlerësimi.

Kjo duhet të parandalojë interpretimet e ndryshme për gjendjen e punëve të brendshme nga ana e Komisionit, Shteteve Anëtare, vendeve Candidate dhe aktorëve të jashtëm të pavarur të shoqërisë civile.

Duke patur parasysh rëndësinë e vendosjes së qëllimeve komplekse dhe ambicioze, prej të cilave para së gjithash do të përfitonin qytetarët, përkundër pranimet në BE, parashikueshmëria do të sigurojë një strukturë nxitëse për reformat shpesh herë të dhimbshme, të cilat në pjesën më të madhe janë të kushtueshme në kushtet afatshkurtër.

Prandaj, BE-ja duhet të përcaktojë një datë të synuar të Zgjerimit që institucionet e saj dhe vendet anëtare të angazhohen për këtë, duke mundësuar rishikime vjetore, për të parë nëse po afrohet apo po nxitet të largohet më tej.



Ky projekt po implementohet nga:
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCIC), Maqedonia e Veriut

në bashkëpunim me:
Qendra për Studimin e Demokracisë (CSD), Bullgari
Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Shqipëri
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, (IDM) Shqipëri
Qendra për Iniciativat Qytetare (CCI), Bosnja dhe Hercegovina
ZastoNE, Bosnja dhe Hercegovina
Partneriteti për Zhvillimin Social (PSD), Kroaci
Instituti Riinvest, Kosovë
Instituti për Demokraci 'Societas Civilis' Shkup (IDSCS), Maqedonia e Veriut
Qendra për Tranzicion Demokratik (CDT), Mali i Zi
Instituti Alternativa (IA), Mali i Zi
Qendra për Politika Bashkëkohore (CCP), Serbi
Fondacioni Turk për Studime Ekonomike dhe Sociale (TESEV), Turqi



Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian (BE).
Përmbajta e këtij dokumenti është përgjegjësi e SELDI.NET dhe nuk pasqyron
detyrimisht pikëpamjet e BE-së.

Sekretariati i Koordinimit dhe Ekzekutivit

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim
Ndërkombëtar
Kutia Postare 55 rr."Nikola Parapunov" 41a
Shkup, Maqedonia e Veriut
Tel: +389 2 3065 381
Fax: +389 2 3065 298

Koordinator Metodologjik

Qendra për Studimin e Demokracisë
rr. 5 Alexander Zhendov
1113 Sofje, Bullgari
Tel: +359 2 971 3000
Fax: +359 2 971 2233
Email: seldi@online.bg